



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.27.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR
INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Selvete Foniqi (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	15
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Leter-konfirmimi nga IAP	21

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/12/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Institucioni i Avokatit të Popullit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Avokati i Popullit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Avokati i Popullit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të IAP-it.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

IAP-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Plani i prokurimit për vitin 2018.

Në kontekst të PFV-ve dhe kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi. Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

IAP ka kontrollë të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,373,167	1,187,774	1,126,242	963,723	1,013,390
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,373,167	1,137,359	1,101,032	928,199	991,662
Donacionet e jashtme	-	50,415	25,210	35,524	21,728

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 185,393€. Kjo është rezultat i reduktimit të buxhetit me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2018, IAP ka shpenzuar 1,126,242€ apo 95% të buxhetit final, me një përmirësim prej 15% krahasuar me vitin 2017. Në përgjithësi, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,373,167	1,187,774	1,126,242	963,723	1,013,390
Pagat dhe Mëditjet	957,314	869,527	857,897	689,331	618,206
Mallrat dhe Shërbimet	324,353	257,928	211,056	235,219	324,720
Shërbimet komunale	25,500	15,500	12,473	24,525	20,264
Investimet Kapitale	66,000	44,819	44,816	14,648	50,200

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimet që kanë pasur janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditje me vendimin e Qeverisë Nr. 07/80 të dt.18.12.2018 ishte zvogëluar 87,790€. Ky zvogëlim ishte rezultat i kursimeve buxhetore pasi që pozitat e planifikuara për katër këshilltarë juridik nuk ishin plotësuar. Shpenzimet në këtë kategori ishin 99% të buxhetit;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 66,426€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i kursimeve buxhetore për shkak se disa aktivitete të prokurimit ishin anuluar dhe disa të tjera ishin të varura nga kontratat e centralizuara të AQP-së. Shpenzimi i buxhetit në mallra ishte 82%;
- Në kategorinë për shërbime komunale buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 10,000€. Kjo si rezultat i kursimeve buxhetore pasi që Ministria e Administratës Publike ka marrë përgjegjësitë që në vitin 2018 ti kryej të gjitha obligimet apo shpenzimet e faturave të rrymës dhe obligimeve tjera komunale në tërë objektin ku është vendosur IAP. Në këtë kategori shpenzimi ishte 80% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 21,181€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i kursimeve buxhetore. Në këtë kategori shpenzimi ishte 100%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me Thesarin.

Në vitin 2018 shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 857,897€. Lidhur me këtë, ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, avancimet, largimet, pushimet e lehonave, nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës). Nga testimet tona nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitetë) në vitin 2018 ishte 273,427€ . Prej tyre ishin shpenzuar 223,529€ apo 82%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me furnizimet për zyrë, shpenzimet tjera kontraktuese, shpenzimet komunale dhe shpenzimet e tjera. Në mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Investimet kapitale

Në vitin 2018, shpenzimet për investime kapitale ishin 44,819€ apo 100% e buxhetit final. Këto shpenzime kanë të bëjnë me blerjen e dy veturave për nevojat e IAP-së. Procedurat për blerjen e veturave janë udhëhequr nga AQP-ja.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 93,257€, pasuritë nën 1,000€ ishin në vlerën 75,781€ ndërsa stoqet 24,912€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit si dhe mbajtja e evidencës se a është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Lidhur më testet tonë, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim:

Çështja A1²- Raportimi i pasurive nën 1,000€

Gjetja Neni 22 i rreg. Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcakton që të gjitha pasuritë kapitale dhe jo kapitale duhet t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Ndërsa neni 24 përcakton që paraqitja në pasqyrat vjetore financiare për pasuritë nën 1,000€ duhet të bëhet nga sistemi e-pasuria me vlerë kontabël neto.

Lidhur me testimet e pasurive ne kemi vërejtur që IAP e përdorë sistemin e-pasuria, mirëpo ky regjistër nuk ishte i saktë, pasi që për të gjitha pasuritë e evidentuara nuk ishte aplikuar zhvlerësimi për vitin 2018.

Për shkak të mangësive në sistemin e-pasuria, IAP në PFV kishte prezantuar pasuritë nën 1,000€ në bazë të kalkulimeve të brendshme (në formatin Excel). Për këto, ne kemi testuar kalkulimin e normave të zhvlerësimit tek regjistri në Exel dhe nuk kemi vërejtur se ka gabime.

Arsyeja që IAP kishte përdorë për raportim formatin Exel në vend të e-pasurisë, ishte për shkak se MAP-i nuk e kishte bërë zhvlerësimin përkundër që zyrtarët e IAP-së kishin kërkuar që të bëhet zhvlerësimi para raportimit të gjendjes së pasurisë në PFV.

Rreziku Mos kalkulimi i zhvlerësimit në sistemin e-pasuria, duke prezantuar pasurinë nga formati Exel rrit rrezikun e shpalosjes jo të saktë dhe të plotë të pasurive nën 1,000€ në PFV.

Rekomandimi A1 Avokati i Popullit duhet të sigurohet që regjistri e-pasuria është duke kalkuluar zhvlerësimin dhe se prezantimi i tyre në PFV të jetë nga sistemi e-pasuria.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

Çështja B1- Mos azhurnim i regjistrit të pasurive

Gjetja

Neni 9 i rreg. Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcakton se tjetërsimi i pasurive bëhet me vendim nga ZKA, i cili bazohet nga rekomandimet e komisionit për vlerësim dhe inventarizim. Arsyeshmëria e tjetërsimit të pasurisë duhet të bazohet në faktin që pasuria është e pa përdorshme dhe jashtë funksionit të organizatës buxhetore.

Lidhur me këtë, IAP me vendimin e dt.03.12.2018, kishte aprovuar rekomandimin e komisionit për tjetërsimin e pasurisë jo financiare që t'ju dhuroj si donacion pasurinë (pajisje dhe inventar)³ një Organizate jo Qeveritare. Për këto pasuri ne vërejtëm që IAP nuk i kishte fshirë nga regjistri i e-pasurisë.

Sipas zyrtarit të pasurive, çështja e mos largimit nga sistemi e-pasuria, e pasurive të tjetërsuar ka ardhur si rezultat i problemeve me funksionimin e sistemit e-pasuria.

Rreziku

Mbajtja në regjistrin e pasurive, pasurit të cilat janë tjetërsuar, rezulton që sistemi i e-pasurisë të nxjerr informata jo të sakta dhe të rrit rrezikun që pasuritë të mbivlerësohen dhe të mos jenë të sakta për nga vlera dhe sasia me rastin e prezantimit të tyre në PFV.

Rekomandimi B1 Avokati i Popullit duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit (tjetërsimit) sipas vlerësimeve të komisionit përkatës.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve për vitin 2018 ishte 2,235€. Obligimet kryesisht kanë mbet si rezultat i pranimit të faturave në fund të vitit 2018 apo pas mbylljes së vitit fiskal. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

³ Një listë e pasurive prej 49 artikujve me pajisje dhe inventar

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

IAP në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në IAP në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Lidhur me rekomandimet kishte progres në zbatimin e tyre si dhe kishte përgatitur regjistrin e rreziqeve, duke identifikuar rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. IAP kishte plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit dhe brenda afatit kishte dërguar në MF. Ndërsa Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në IAP përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe atë strategjik. Në vitin 2018 kishte planifikuar dhe kryer katër auditime të rregullta dhe një me kërkesë të menaxhmentit.

NJAB kishte përmbushur në tërësi planin e auditimit duke dhënë tre rekomandime për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme prej tyre një ishte zbatuar dhe dy ishin në proces të zbatimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në IAP funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me drejtuesit e departamenteve dhe përgatit raporte për këto takime.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të IAP-së ka rezultuar në katër rekomandime. Për këto IAP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të vitit 2018, IAP kishte zbatuar tre rekomandime ndërsa një rekomandim ishte përsëritur edhe këtë vit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën 3.

Tabela 3. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Avokati i Popullit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me prezantimin jo të duhur tek realizimi i buxhetit dhe donacioneve të pashpenzuar në PFV. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet në Ministri të Financave, përveç nëse ndaj PFV janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.	Në vitin 2018, në PFV ishin prezantuar drejtë realizimi i buxhetit dhe donacioneve të pashpenzuara.	I zbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Avokati i Popullit duhet të sigurojë që me rastin e planifikimeve buxhetore të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale (mjeteve financiare) dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit në paga dhe mëditje dhe mallra e shërbime.	IAP kishte përmirësim të shpenzimit në nivel të përgjithshëm për 15 % në raport me vitin e kaluar. Këtë vit shpenzimet ishin 95% e buxhetit kurse vitin e kaluar ishin 80%.	I zbatuar.
3	Menaxhimi pasurisë	Avokati i Popullit duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës.	Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, edhe këtë vit kemi vërejtur që pasuria e tjetërsuar nuk ishte larguar nga regjistri e-pasuria.	I përsëritur.
4	Qeverisja e mirë	Avokati i Popullit duhet t'i shqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të listës së rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Është krijuar grupi punues për monitorimin dhe raportim e rreziqeve si dhe kanë filluar të mbajnë takime.	I zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Menaxhimi pasurisë	Avokati i Popullit duhet të sigurohet që regjistri e-pasuria është duke kalkulluar zhvlerësimin dhe se prezantimi i tyre në PFV të jetë nga sistemi e-pasuria.		
2	Menaxhimi pasurisë	Avokati i Popullit duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit (tjetërsimit) sipas vlerësimeve të komisionit përkatës.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër-konfirmimi nga IAP



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, 6 maj 2019

z. Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm
Zyra Kombëtare e Auditimit

LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

I nderuar z. Osmani,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin, ndërsa nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.


Me nderime,
Hilma Jashari
Avokat i Popullit